VENDIM
Nr.272, datë 28.4.2005

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.405, DATË 8.1.1996 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR ADMINISTRIMIN E RRJETIT RRUGOR KOMBËTAR DHE RRJETIT RURAL TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.405, datë 8.1.1996 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Në pikën 1, rrjetit rrugor kombëtar t'i shtohen dhe 30 km rrugë.

2. Në lidhjen 1, "Rrjeti rrugor kombëtar", që i bashkëlidhet vendimit, shtohet emërtimi:

"Drejtorisë rajonale të mirëmbajtjes së rrugëve, Gjirokastër, Ura e Kardhiqit-Fushë-Bardhë-Delvinë, 30 km rrugë interurbane, dytësore".

3. Në tabelën "Inventari i rrugëve rurale, rajonale e komunale", që i bashkëlidhet vendimit, të hiqet emërtimi "Ura e Kardhiqit-Fushë-Bardhë-Delvinë".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano